



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhe, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sherbimi i mbikqyerjes se punimeve me objekt: “Rikonstruksioni I kanalit ujtes dega kryesore Koterr-Kakarriq, segmenti Gjader-Gocaj, Bashkia Lezhe Loti II-te”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,131,101.97 (nje milion e njeqind e tridhete e njemije e njeqind e nje pike nentendhete e shtate) Lekë pa TVSH.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuara më sipër. (Shtojcat).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave

nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumn e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për mbikqyrje të punimeve të zbatimit si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës.

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP- 1 Punime gjurmimi në tokë.

NP- 7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

NP- 12 Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS- 18 Punime topogjeodezike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr. 943, Datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit Të Ministrave, "Për Licencimin Profesional të Individëve dhe Personave Juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

AK-ja në përcaktimin e kategorive të licencës së kërkuar në këtë procedurë prokurimi merr në konsideratë Ligjin Nr. 8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pasi në përzgjedhjen e kategorive dhe klasave të licencës, duhet që licencat e mbikqyrësit janë të njëjta me ato të ndërtuesit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 4 (kater) punonjës për periudhën Prill 2026 – Qershor 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;

b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjisllacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhen e kerkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kerkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se shërbimet që kerkohet të kryhen janë për punime të shtrira në territor. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në licencën e shqërisë (Drejtues teknik) personeli si më poshtë:

a. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
b. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
c. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)	Diplome Universitare
d. Inxhinier Gjeodet	1 (nje)	Diplome Universitare

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Licencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhen Prill 2026 – Qershor 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr. 943, Datë 28.12.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, Datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik për afatin e kerkuar në listëpagesa i vërteton AK se operatori ekonomik ka një staf të qëndrueshëm, operativ i cili do të kryejë shërbimin në kohë dhe cilesi.

2.3.5 OE duhet te kete ne pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi instrumentat topografik si me poshtë:

- 1 (nje) paisje GPS

- 1 (nje) paisje Total Station

Per kete duhet te paraqesë fature tatimore shit-blerje ose kontrate qiraje/bashkepunimi ku i bashkengjitet fatura tatimore.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3.6 OE duhet të ketë në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi nje automjet.

Per kete duhet te paraqesë:

- Ne rast te disponimit te automjetit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: çertifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore.
- Ndersa per mjete te marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3.7 Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre duhet ti referohen VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim", si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr. 5585 Prot "Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim".

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë.11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim", do të skualifikohen.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimit sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontrates. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë

vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar termat e references, ne te cilat theksohet se jane shprehur qarte kerkesat AK per cilesine e te gjitha sherbimit per realizimin e kontrates.

Po ashtu Njesia pergjegjese thekson se ne specifikimet teknike/termat e references nuk eshte permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmartjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT